6. Emertimi I shoqerise të krijuar nga perthithja eshte "LIQENI VII " sha.

7. Selia e shoqerise do te jete ne Durres.

8. Drejtor I shoqerise eshte z. Ramazan Kalia.

9. Keshilli mbikqyres perbehet nga :

Hysni Basha

Ramiz Gosturani

Xhevdet Kariqi.

10. Objekti I veprimtarise se shoqerise eshte : Prodhim dhe tregetim pjese kembimi per makineri bujqesore, te ndertimit, transportit etj.

Tregtim me shumice e pakice te çdo lloj detali, nyje apo aksesori te makinerive bujqesore.

Import eksport te mallrave, materialeve, makinerive dhe lendve te para qe kane lidhje me aktivitetin e saj prodhues dhe tregtar.

Import eksport, tregetim me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale e ushqimore.

Shfrytezim, perpunim dhe tregtim te lendes drusore, prodhim dhe tregtim mobilje.

Mbareshtrim pyjor, pyllezime e permiresime pyjore, mbareshtim te faunes, mbrojtjen e pyjeve nga semundjet, demtuesit dhe nga zjarri, mbareshtim kullotash e livadhesh, gjelberim qytetesh e parqesh kombetare. Projektim, ndertim dhe rikonstruksion rrugesh pyjore.

Punime te ndryshme ndertimi.

Ndertim objekte social kulturore e banimi, projektim e zbatim I tyre.

Ndertim rruge e kanalizime, asfaltime, ura e vepra arti.

Prodhim per perdorim dhe shitje te materialeve inerte. Hapjen e linjave te inerteve, asfalto – betoneve etj, materiale ndertimi.

Rikonstruksione te cdo lloji.

Tregetim me pakice te karburanteve dhe vajra lubrifikante. Tregetim me shumice e pakice te pjeseve te kembimit per automjete, servis automjetesh.

Bar, restorant, hotel. Agjensi turistike dhe udhetimesh. Agjensi per shitjen e biletave te transportit ajror, detar, hekurudhor, urban e interurban.

11. Mbylljen pa likuidim te shoqerise " KALIA " shpk.

12. Depozitimin e aktit te themelimit dhe statutit te ri te shoqerise se re te krijuar nga perthithja.

Urdherohet zyra e regjistrit tregtar të beje pasqyrimin e ndryshimeve ne kollonat perkatese, duke I ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE

Blerina MUÇA

Al.244/5
24.04.2003

KERKESE

KERKUESI: Ramazan Kalia , i datelindjes 1963, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar me cilesine e drejtorit te shoqerise "Mekanike Pjese Nderrimi" Sh.a, Durres

OBJEKTI: Depozitim prane Zyres se Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit Nr. 2 dt. 31.03.2003 i Asamblese se aksionereve te shoqerise.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 7638 dt. 19.11.1992 dhe ligji Nr. 7667 dt. 25.01.1993

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

Me cilesine e kerkuesit po i drejtohem kesaj te nderuare Gjykate qe te bej depozitimin e vendimit Nr. 2 dt. 20.03.2003 te te Asamblese se aksionereve te shoqerise ne te cilen eshte vendosur:

1. Miratimin e aktit te ekspertimit te kryer nga ekspertja Adriana Kalaja.
2. Miratimi e shtimit te kapitalit ne natyre te shoqerise ne masen 4.954.652 leke.
3. Ndryshimin e raporteve te aksionereve ne kapitalin themeltar sipas aktit te ekspertimit.
4. Kapitali themeltar i shoqerise pas shteses behet 84.354.652 leke kundrejt 84354 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.
5. Depozitimin e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

Per sa me lart ju lutemi te pranoni kerkesen dhe te caktoni nje date per shqyrtim.

Per shoqerine "Mekanike Pjese Nderrimi"Sh.a

Ramazan Kalia

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE TIRANE
Nr. 1765 Rep
Nr. — Kol

VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 22/04/2003, para meje noterit N. Muratj me Zyre ne Tirane, u paraqiten personalisht Ramazan Kalia dhe per identitetin e te cilit u sigurova nga certifikata perkatese, me zotesi juridike per te vepruar i cili deklaroi se sipas vullnetit dhe deshires se tij te lire ka nenshkruar para meje noterit Kerkesen e une noteri e vertetoj sipas ligjit.

NOTER
Nejir Muratj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA ANONIME "MEKANIKE PJESE NDERRIMI"
Lagja Nr.14,Rruga Tiranes Durres

PROCES VERBAL

I MBLEDHJES SE JASHTEZAKONESHME DHE TE ZAKONSHME TE ASAMBLESE SE AKSIONEREVE TE SHOQERISE ANONIME "MEKANIKE PJESE NDERRIMI",SHKOZET DURRES

I mbajtur sot me date 31.03.2003 ne oren 12.00 ne seline e Sh.A."MEKANIKE PJESE NDERRIMI"Shkozet, Durres ,Lagja 14,Rruga e Tiranes.

Asambleja e jashtezakonshme e shoqerise mblidhet per te diskutuar dhe vendosur ne baze te rendit te dites si me poshte:

1.Verifikimi i vlefshmerise se mbledhjes

2.Thirrja e mbledhjes se jashtezakonshme te aksionereve me rend dite:

- Zmadhimi i Kapitalit te Shoqerise 'MEKANIKE PJESE NDERRIMI",zmadhim ky si kontribut ne natyre.
- Miratimin e Aktit te Ekspertimit ne lidhje me kete zmadhim pergatitur nga Ekspertja Adriana Kalaja bazuar ne vendimin e Gjykates Nr.21244/4 dt.11.03.2003.

3. Thirrja e Asamblese se zakoneshme te Aksionereve te shoqerise per:

4.Miratimi I bilancit ushtrimor per vitin 2002.

5.Te ndryshme.

Mbledhja thirret dhe organizohet mbi bazen e njoftimit te Drejtorise se Sh.A-se Date 04.03.2003.

Ne mbledhje marrin pjese aksioneret e shoqerise,z.Ramazan Kalia qe perfaqeson 51.063% te aksioneve te shoqerise,aksioneret punonjes te shoqerise Ilmi Keci,Abedin Cami,Ismail Taipi,qe perfaqesojne 0.282% te aksioneve te shoqerise si dhe Perfaqesuesi i aksionerit shtet Dhurata Hoxha qe perfaqeson 44.372% te aksioneve te shoqerise.

Perfaqesuesi i aksionerit shtet eshte paraqitur me autorizimin Nr.2170/2 Prot. date 25.03.2003 leshuar nga Ministria e Ekonomise.

Jane gjithashtu te pranishem:

Z.Sabri Limanaqi me cilesine e Noterit te Dhomes Notereve Durres.

Z.Adriana Kocillari me cilesine e mbajtesit te protokollit.

Z.Ramazan Kalia qe u zgjodh si Kryetari i Asamblese.

Z.Ramazan Kalia i paraqet aksionereve materialin e pergatitur qe eshte raporti i Ekspertes se Vleresimit te Kapitalit si edhe disa te dhena nga bilanci I vitit 2002 te cilat u paraqiten edhe nga financierja.

1.Mbledhja konsiderohet e vlefshme dhe pasi votohet ne unanimitet te plote vendoset vazhdimi i saj me 95.717 % te votave.

Pas leximit te materialit te paraqitur nga Drejtoria e Sh.A-se dhe sqarimit te pyetjeve rreth materialit u vendos;

1.Miratimin e Aktit te Ekspertimit kryer nga ekspertja Adriana Kalaja si me poshte:

a.Miratimin e shtimit te kapitalit te shoqerise ne masen 4.954.652 leke

b.Ndryshimin e raporteve te aksionereve ne kapitalin themeltar sipas aktit te ekspertimit ku:

-Z.Ramazan Kalia me 53.9% te kapitalit themeltar.

-Pronari shteteror Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit me 41.8% te kapitalit themeltar.

-Paketa e 54 punonjesve te shoqerise me 4.3% te kapitalit themeltar

c.Kapitali I Shoqerise pas shteses behet 84.354.652 leke kundrejt 84354 aksione vlere nominale 1000 leke secili.

d.Te depozitohet ky vendim prane Zyres se Kregjistrit Tregetar te gjykates se shkalles se pare Tirane.

Ne mbledhjen e zakoneshme te Shoqerise u vendos:

1.Miratohet bilanci ushtrimor per vitin 2002 si me poshte:

Aksioneret e pranishem votojne me 95.717% te votave qe humbja te mbartet ne vitin 2003.

Meqenese u diskutuan te gjitha pikat e rendit te dites mbledhja e zakonshme dhe e jashtezakonshme e shoqerise e cila filloi ne oren 12.00 te dates 31.03.2003 dhe perfundoi ne oren 13.00 te po kesaj date konsiderohet e mbyllur dhe proces-verbali pasi lexohet dhe nuk ka verejtje firmoset nga te gjithe palet si me poshte:

AKSIONERET

1.Ramazan	Kalia	Zoterues	51.063% te aksioneve	Ramazan Kalia
2.Dhurta	Hoxha	Perfaqesues	44.372% " "	Dhurta Hoxha
3.Ilmi	Keci	" "	0.094% " "	H. Keci
4.Ismail	Taipi	" "	0.094% " "	Ismail Taipi
5.Abedin	Cami	" "	0.094% " "	Abedin Cami

KRYETAR I ASAMBLESE

Ramazan Kalia

Ramazan Kalia

PROTOKOLLUESI

Adriana Kocillari

Adriana Kocillari

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
NR 1097 REP

REPUBLIKA E SHQIPERISE SABRI R. LIMANAQI NOTER DURRËS

V E R T E T I M

Ne qytetin e Durresit sot me date 31.03.2003 (Dymije e tre) diten e Hene une Noteri Publik Sabri Limanaqi me Zyra ne Lagjen Nr 2 Rruga "Sefer Efendiu Durres,asistova ne mbledhjen e e Jashtezakoneshme dhe te Zakoneshme te Asamblese se Aksionereve te Shoqerise Anonime " Mekanike Pjese Ndrimi" Shkozet Durres dhe vertetoj se ky Proçes Verbal prej dy Faqesh i dates 31.03.2003 eshte ne perputhje te plote me diskutimet e proposimet e aksionereve pjesmarrja e te cileve ishte 95.717 %.

Pjesemarresit ne mbledhje jane te gjithe madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar per identitetin e te cileve u sigurova me ane te Pasaportes ose Leternjoftimit te tyre2

Une Noteri vertetoj rregullsine ligjore te mbajtjes se ketij Proçes-Verbali

N O T E R I

SABRI LIMANAQI

PULLE TAKSE REPUBLIKA E SHQIPERISE SABRI R. LIMANAQI 100 LEKË NOTER DURRËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE

Nr. 2170/2 Prot.

Tiranë, më 25-3-2003

A U T O R I Z I M

Ne zbatim te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe te Ligjit Nr.8885, date 22.04.2002 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarjeve shteterore ne shoqeri tregetare", me cilesine e zoteruesit te 44.4% te aksioneve shteteror ne sh.a "Mekanike Pjese Nderrimi" Durres, autorizohet Zj,Dhurata Hoxha pergjegjese sektori ne Drejtorine e Politikave te Privatizimit te Sektoreve Strategjik, ne Ministrine e Ekonomise, te marre pjese ne Mbledhjen e zakonshme te Asamblese se Aksionereve te Shoqerise me rendin e dites bashkelidhur.

Mbledhja zhvillohet ne daten 25.03.03, ora 11 ne Seline e shoqerise.

Arben MALAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E EKONOMISË TIRANË

MINISTER

Adresa: Bulevardi "Zhan d'Ark", Nr. 3; Tel. ++355(4) (tel.drejt.) / 222 652; Fax: ++355 (4) (Fax. Drejt)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE

Nr. 2170/1 Prot.

Tiranë, më 25.3. 2003

Lënda : Qendrimi qe do te mbahet ne mbledhjen e Asamblese se Zakoneshme te Aksionereve ne "Mekanike Pjese Nderrimi"sh.a.

PERFAQESUESI I AKSIONERIT SHTET

NE SH. A "MEKANIKE PJESE NDERRIMI"

DURRES

Ne mbeshtetje te njoftimit per thirrjen e Asamblese se zakonshme te shoqerise "Mekanike Pjese Nderrimi", ne daten 25.03.2003 ora 11.00 prane selise se shoqerise, ne lagjen 14, Rr "Tirane-Shkozet-Durres", perfaqesuesi i aksionerit Shtet te mbaje qendrimin si me poshte:

- Miraton piken 1 te rendit te dites , pasqyruar ne kerkesen e bere nga shoqeria per mbledhje asambleje "Miratimin e bilancit ushtrimor per vitin 2002".Humbja e ushtrimit te mbartet ne bilancin kontabel te vitit 2003.
- Nuk miraton piken 2 te rendit te dites "Te ndryshme". Duhet specifikuar ne thirrjen e bere nga shoqeria se ç'perfaqeson pika 2, ne menyre qe perfaqesuesi i Shtetit te njihet me praktiken perkatese per çdo problem qe do diskutohet ne mbledhje.
- Miratojme raportin e ekspertes te caktuar nga Gjykata per vleresimin e kontributeve ne natyre.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E EKONOMISË TIRANE

Arben MALAJ
MINISTËR

Adresa: Bulevardi "Zhan d'Ark", Nr. 3; Tel: ++355(4) (tel.drejt.) / 225 154;

REPUBLIKA SHQIPERISE
SHOQERIA ANONIME
"MEKANIKE PJESE NDERRIMI"DURRES

V E N D I M

Nr. 2 dt. 31.03.2003

I mbajtur sot me dt. 31.03.2003 ne seline e Sh.A "MEKANIKE PJESE NDERRIMI"Shkozet,Durres.Asambleja e jashtezakoneshme e shoqerise me pjesemarrjen e 95.717% te aksionereve ,pasi analizuan Aktin e Ekspertimit kryer nga Ekspertja Adriana Kalaja e caktuar nga Gjykata per vleresimin e kontributeve ne natyre.

V E N D O S E M :

1.Miratimin e Aktit te Ekspertimit kryer nga ekspertja Adriana Kalaja e caktuar nga Gjykata per vleresimin e kontributeve ne natyre si me poshte:

a.Miratimin e shtimit te kapitalit te shoqerise ne masen 4.954.652 leke .

b.Ndryshimin e raporteve te aksionereve ne kapitalin themeltar sipas aktit te ekspertimit ku:

-Z.Ramazan Kalia me 53.9%

-Pronari shteteror Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit me 41.8% te kapitalit themeltar.

-Paketa e 54 punonjesve te shoqerise me 4.3% te kapitalit themeltar.

c.Kapitali themeltar I shoqerise pas shteses behet 84.354.652 leke kundrejt 84354 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.

d.Depozitimin e ketij vendimi prane zyres se Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

AKSIONERET

1.Ramazan	Kalia	Zoterues	51.063% te aksioneve	Ramazan Kalia
2.Dhurata	Hoxha	Perfaqesues	44.372% " "	Dhurata Hoxha
3.Ilmi	Keci	Zoterues	0.094% " "	
4.Ismail	Taipi	"	0.094% " "	Ismail Taipi
5.Abedin	Cami	"	0.094% " "	Abedin Çami

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
NR 1098 REP

V E R T E T I M

Ne qytetin e Durresit sot me date 31.03.2003 (Dymije e tre) diten e Hene une Noteri Sabri Limanaqi me Seli ne Lagjen Nr 2 Rruga "Sefer Efendiu" Durres,asistova ne mbledhjen e Jashtezakoneshme dhe te Zakoneshme te Asa mblese se Aksionereve te Shoqerise Anonime "Mekanike Pjese Ndrimi" Shkozet Durres dhe vertetoj se Vendimi i mare nga Asambleja e Jashtezakoneshme e Shoqerise me pjesemarrjen e 95.717 % te sjae Nr 1 Date 31.03.2003 per Miratimin i Aktit Ekspertimit nga Ekspertja Adriana Kalaja eshte ne perput je te plote sipas Ligjit.
Pjesemarresit ne mbledhje jane te gjithe madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar per identitetin e te cileve u sigurova me ane te Pasaportes ose Leternjoftimit te tyre.

Une Noteri vertetoj rregullsine ligjore te ketij Vendimi

N O T E R I

SABRI LIMANAQI

PULLE TAKSE

AKT-EKSPERTIMI PER ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR

Une Adriana Kalaja, eksperte kontabel me Nr. liçence 744, jam caktuar me Vendim Nr.1, date 20.09.2002 te Asamblese se Aksionereve te SH.A. "Mekanike Pjese Nderrimi" Durres ne lidhje me shtimin e kapitalit te shoqerise dhe rregullimin e raporteve te kapitalit themeltar.

Per te kryer misionin tim u mbeshteta ne keto dokumentacione:

- Ligjin Nr.7638, date 19.11.1992 'Per Shoqerite Tregtare"
- Vendimin Nr.1, date 20.09.2002 te Asamblese se Aksionereve
- Bilancin e krijimit te shoqerise SH.A. "Pjese Nderrimi Mekanike" Durres, si dhe bilancin e dates 31.12.2002.
- Statutin e shoqerise si dhe net e gjithe dokumentacionin perkates te shoqerise.

Me vendim Nr.21244, date 29.04.1999 te Gjykates Rrethit Tirane eshte krijuar shoqeria SH.A. "Pjese Nderrimi Mekanike" Durres, me kapital themeltar 79.400.000 lek, i ndare ne 79.400 aksioneve me vlere nominale 1000 leke.

Me Vendim Nr.21244/1, date 24.03.2000 te po kesaj Gjykate jane tranferuar 51% e aksioneve te shoqerise "Mekanike Pjese Nderrimi" SH.A. tek aksioneri i ri z. Ramazan Kalia nepermjet privatizimit me ankand pa cmim fillestar.

Me vendim Nr.21244/3, date 14.07.2001 u eshte tranferuar paketa e aksioneve punonjesve te shoqerise ne masen 4.6284635% me vlere 3.675.000 leke, ne 3.675 aksione qe i perkasin 54 aksionereve.

E caktuar me cilesine e ekspertit kontabel kam kryer vleresimin e rritjes se kapitalit te shoqerise, duke ndryshuar raportet ndermjet aksionereve dhe duke ruajtur vleren nominali te nje aksioni te barabarte me 1000 leke.

1. OPINIONE PER VLERESIMIN E AKTIVIT

Ne baze te ekzaminimit kontabel per aktivet e qendrueshme te trupezuara te pasqyruara ne bilanc per vleren neto kontabile 66.036.154 leke bazuar ne dokumentat kontabel te shoqerise, rezultoi se ato jane pasqyruar ne kontabilitet

me vleren historike dhe vlera e inventarit kontabel te kryer nga shoqeria me 31.12.2002 perputhet me ate te pasqyruar ne bilancin perkates si vijon:

2. OPINIONE MBI PASIVIN E BILANCIT

Ne kapitalet e vet ate bilancit vlera per 51.660.212 leke perfaqeson kapitalet e veta te shoqerise, e cila perbehet nga vlera e kapitalit themeltar 79.400.000 leke.

Rezerve rivleresimi	11.193.604 leke
Rezerva te tjera	110.130 leke
Provigjone	3.395.372 leke
Humbje te trasheguara	42.439.254 leke

Ne verifikimin e kryer ne rubriken e bilancit Detyrime ne vleren 20.807.293 leke rezulton se ajo perbehet nga Detyrime te kerkueshme me shume se nje vit per 8.698.249 leke dhe Detyrime deri ne nje vit 12.109.044 leke.
Ne postin Detyrime si ne atom bi nje vit dhe ne ato deri ne nje vit ekziston zeri ortak ne shumen totale 16.876.500 leke ku perfshihen financimet dhe investimet e bera nga aksioneri zoterues i 51% te aksioneve.
Me date 20.09.2002 Asambleja e Aksionereve ne mbledhjen e jashtezakonshme me unanimitet ka miratuar investime per rikonstruksionin e objekteve dhe ambienteve te shoqerise.
Keto investime do te perballohen me mjete te ortakut privat z. Ramazan Kalia qe zoteron 51% te aksioneve, duke i kryer veprimet nepermjet nje llogarie bankare, pas perfundimit te punimeve te behet kontabilizimi i konstruksioneve per librat kontabel dhe mbi kete baze te behet rregullimi i raportevete kapitalit themeltar te shoqerise.
Ne mbylljen e llogarive vjetore (bilanci) te ushtrimit 2000 – 2001 – 2002 eshte pergatitur dokumentacioni i ketyre investimeve dhe eshte mare ne evidencen kontabel per kete vit ushtrimor financiar, ka gjetur pasqyrim te plote ne te gjithe pasqyrat financiare te shoqerise.
Investimet sipas ketij programi te kryera ne sipermarrje nga shoqeria "ARMANDI" sh.p.k Durres dhe qe jane marre ne dorezim nga administrate e

shoqeriseduke i bere dhe pagese sipermarresit nepermjet nje llogarie bankare te celur per kete qellim, po jua paraqesim si me poshte:

- situacion rikonstruksion i catise se rep. mekanik	1.473.909 leke
- situacion rikonstruksion i catise se rep. mekanik	217.970 leke
- situacion rikonstruksion i fasades rep.mekanik	1.709.650 leke
- situacion cmontim, transportim makineri metal – prerese	189.565 leke
- situacion pastrim, system, kullime, nivelim te fushes celiqeve	1.100.665 leke
- situacion rikonstruksion zyrash	262.905 leke
Vlera TOTALE e investimeve te kryera	**4.954.652 leke**
Trualli (toka)	6.641.935leke
Ndertesa	59.837.757 leke
Investime	4.954.645 leke
Instalime teknike, vegla pune	84.409.225 leke
Mjete transporti	270.000 leke
TOTALE vlera kontabel bruto	**150.113.561 leke**
Amortizimi i akumuluar	90.077.407 leke
TOTALE Vlera kontabel neto	**60.036.154 leke**

Per verifikimin dhe vleresimin e tyre u bene sondazhe me dokumenta kontabel sipas elementeve dhe klasifikimit te tyre dhe rezultoi se ato ekzistojne fizikisht dhe jane prone e shoqerise, ndaj vlera kontabel neto merret ne konsiderate per zmadhimin e kapitalit pasi ajo perben nje aktiv real per shoqerine.

Ne kontrollin e kryer per postin e bilancit gjendjet e inventarit ne proces per vleren 327.147 leke rezultojne se ajo rakordon me inventarin kontabel te stokut te kryer nga shoqeria me shoqeria me 31.12.2002.

Ne postin e bilancit kerkese per arketime mbi debitoret vlera 5.730.427 leke ne baze te verifikimit te kryer rezulton se vlera e pasqyruar ne bilancin ushtrimor 2002 rakordon me inventarin kontabel te llogarive perkatese.

Vlera e pasqyruar ne postin e bilancit kerkesa per arketime mbi debitoret per 5.730.427 leke mbeshtetet ne dokumenta kontabel te rregullta ndaj ajo eshte ne vlere pasurore aktuale per shoqerine ne momentin e vleresimit per zmadhimin e kapitalit themeltar.

Nga kontrolli i kryer ne rubriken e bilancit likuiditete dhe vlera arke te tjera te pasqyruara ne bilancin perkates per 373.775 leke rezulton se ajo perputhet me ekstraktet kontabel perkatese me 31.12.2002 si me poshte:

- depozita ne banke dhe llogari te tjera 45.697 leke
- para ne dore (arke) 328.078 leke

Si konkluzione likuiditetet qe rezultojne gjendje ne 31.12.2002 perbejne nje aktiv real per shoqerine.

Per efekt te zmadhimit te kapitalit te shoqerise vlera e aktivit real qe duhet te merret ne konsiderate rezulton te jete:

- vlera e aktivit total me 31.12.2002 72.467.506 leke
- vlera e aktivit fiktiv -
- vlera e aktivit real me 31.12.2002 72.467.506 leke

3. ZMADHIMI I KAPITALIT TE SHOQERISE

Zmadhimi realizohet nepermjet shnderrimit te kontributit te aksionerit Z.Ramazan Kalia ne shumen 4.954.652 leke.

Kapitali i nenshkruar behet 84.354.652 leke.

Duke patur parasysh se kam permbushur misionin tim per vleresimin e aktiveve dhe pasiveve te shoqerise bazuar ne vlerat e bilancit date 31.12.2002, vertetoj se llogarite kontabile te kesaj shoqerie per efekt te vleresimit te tyre per zmadhimin e kapitalit shprehin vleren pasurore reale te shoqerise qe perfaqesohet nepermjet kapitalit te saj themeltar.

Si konkluzion kapitali themeltar i shoqerise ne fillim te aktivitetit te saj ishte 79.400.000 leke dhe me vleresimet tona bazuar ne legjislacionin perkates behet 84.354.652 leke.

Bashkengjitur ketij relacioni eshte edhe bilanci per percaktimin e vleres se zmadhimit te kapitalit themeltar.

3. PJESMARRJA NE KAPITALIN E SHOQERISE

Pas zmadhimit te kapitali te shoqerise pjesmarrja ne capital rezulton si vijon:

Aksioneri	Nr. aksioneve	Vlera e kapitalit Themeltar	% ne kapital	Vlera e aksion.
TOTALE	**84.354**	**84.354.652 leke**	**100**	**1000**

E ndare si me poshte:

1- Ramazan Kalia	45.449	45.559.000 leke	**53.9 %**
2- Pronari shtet	35.230	35.230.000 leke	**41.8 %**
3- Paketa e 54 punonj.	3.675	3.675.000 leke	**4.3 %**

Ky mision i zmadhimit te kapitalit u krye ne baze te kerkeses se shoqerise.

EKSPERTE KONTABEL

ADRIANA KALAJA

ADRIANA KALAJA
KONTABEL MIRATUAR
TIRANE L.744

PERCAKTIMI I VLERES PER ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR

Nr	Pershkrimi	Aktivi neto	Aktivi neto i korigjuar	Nr	Pershkrimi	Pasivi	Pasivi i korigjuar
A	Kapitali i nenshkruar i pa kerkuar				**Kapitalet e veta (1+2+3+4)**	51.660.212	56.612.864
B	**Aktive te qendrueshme (1+2)**	66.036.154	66.036.154		**Kapitali themeltar rezerva fitim-humbje**	48.154.349	53.109.001
1	**Aktive te qendrueshme te patrupezuara**				Kapitali i nenshkruar	49.400.000	84.354.652
	Shpenzime te nisjes dhe te zgjerimit				Diference nga rivleresimi		
	Te tjera ne shfrytezim marka, patenta etj				Rezervat Rezervat ligjore		
2	**Aktive te qendrueshme te trupezuara**	66.036.154	66.036.154		Fitim ose humbje te mbartura		
	Toka, terrene ndertimore Instalime te pergjithshme	71.434.337	71.434.337		Fitim ose humbje te ushtrimit		
	Instalime teknike, makin. pajisje, vegla pune	84.409.225	84.409.225				
	Te tjera ne shfrytezim	270000	270000		Provigjone per rreziqe		
	Amortizimi	90.077.407	90.077.407		**Detyrime te kerkush mbi nje vit**	8.698.249	3.743.597
	Aktive qarkulluese	6.431.351	6.431.351		Furnitore per blerje dhe sherbime	268.315	268.315
	Gjendje te inventarit dhe prodhim ne proces				Sigurime shoqerore Te ngjashme		
	Materiale te para etj.						
	Produkte e punime ne proces				Shteti tatim taksa	82.277	82.277
	Produkte dhe mallra				Ortak	6.876.500	1.941.848
	Te tjera gjendje inventar						
	Kerkese per ark. mbi deb	1.539.333	1.539.333		Detyrime te tjera	1.471.157	1.471.157
	Te tjera kerkesa	5.730.427	5.730.427				
	Likuiditete dhe vlera arke te tjera	373.775	373.775		Detyrime deri ne nje Vit	12.109.044	12.109.044
	Depozita ne banke	45.697	45.697				
	Para ne dore	328078	328.078				
	Vlera te tjera						
	Llogari te tjera						
	TOTALI AKTIVIT	**72.467.506**	**72.467.506**		**TOTALI PASIVIT**	**72.467.506**	**72.467.506**

EKSPERTI KONTABEL
ADRIANA KALAJA

ADRIANA KALAJA
KONTABEL I MIRATUAR
TIRANE L.744

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE TIRANE
Nr. 1766 Rep
Nr. — Kol

VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 22/04/2003, para meje noterit N. Mirot me Zyre ne Tirane, u paraqiten personalisht Adriana Kalaja dhe per identitetin e se ciles u sigurova nga certifikata perkatese, me zotesi juridike per te vepruar e cila deklaroi se sipas vullnetit dhe deshires se saj te lire kane nenshkruar para meje noterit Aktin e Ekspertimit te Shoqerise "Mekanike Pjese Nderrimi" Sh.a e une noteri e vertetoj sipas ligjit.

NOTER
Hejri Mirot

21244/6

S B Mucaj

05 05 04

2004

KERKESE

KERKUESI : RAMAZAN KALIA , drejtor i shoqerise Mekanike Pjese Nderrimi SHA, me seli ne Durres.

OBJEKTI : Depozitimi i vendimit nr. 1 date 06.05.2004 i Asamblese se zakonshme te Aksioniereve te shoqerise MPN SHA, Vendimi nr.1 date 06.05.2004 i Asamblese se jashtezakonshme te aksionierve te shoqerise MPN SHA. Dhe procesverbalet perkatese te mbledhjeve.

Ligji Nr.7632 date 04.11.1992,Ligji nr.7638 date 19.11.1992, ligji Nr.7667 date 28.01.1993.

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

TIRANE

Shoqeria " MEKANIKE PJESE NDERRIMI " SHA figuron e regjistruar ne Gjykaten e Tiranes, me vendimin Nr.21244 date 24.04.1999.

Kerkohet depozitimi i vendimit nr.1 date 06.05.2004 i asamblese se zaonshme e aksioniereve te shoqerise "MPN " SHA dhe procesverbali perkates.

-Vendimi Nr.1 date 06.05.2004 i asanblese se jashtezakonshme i shoqerise MPN dhe procesverbali perkates.

Te kryhen veprimet perkatese.

KERKUESI

RAMAZAN KALIA

REPUBLIKA SHQIPERISE • DURRES • SHA MEKANIKE PJESE NDERRIMI

Vendim Nr 1 dt 6.5.04 i As Zakonshme te Aksionierve Iv. i Mbl. se Zakonshme te Aksionierve dt. 6.5.04

Vendim Nr 1 dt 6.5.04 i As J. Zak. te Aksion. Iv. i Mbl se J. Zak te Aksionier dt. 6.5.04

Njoftim dt 20.04.04 dhe 28.3.04 i Ma. E Shoqerise Aktorizim i M Ekonomise Nr 2309/3 dt 4.5.04 Shkresë (Gendrim) Nr 2304/4 dt 4.5.04 Shkresë Nr 2950 dt 4.5.04 i M Ek Evidenci pjesëmarje.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR. REP. 5030

VERTETIM

Sot ne Tirane, me date 25.05.2004 (dymije ekater), para meje noteres Fatmara N. Shehu, me seli ne Bul. Gjergj Fishta ", uparaqit personalisht.
KERKUESI :
RAMAZAN KALIA, drejtor i Shoqerise " Mekanike Pjese Kembimi" SHA Durres, me Pasaporte Nr.Z0082664,madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, i cili deklaroi se sa siper, ka nenshkruar sipas ligjit, une noteri e vertetoj rregullisht.

NOTERE
FATMARA SHEHU

E TAKSE
100 LEKE
REPUBLIKA E SHQIPERISE

MEKANIKE
PJESË
NDËRRIMI sh.a

Address :
Ish UMB . Shkozet,Durres
Albania
Tel 00355 52 64846
Fax 00355 52 64846
Email< mpnalb@yahoo.com>

REPUBLIKA E SHQIPERISE AIDA M. SPAHIU NOTER DURRES

Asamblleja e Zakonshme e Aksionereve te Shoqerise " MEKANIKE PJESE NDERRIMI" sh.a , Durres

Date 06 / 05 / 2004

VENDIM NR 1

Asamblleja e Zakonshme e Aksionereve te Shoqerise " MEKANIKE PJESE NDERRIMI" sh.a , Durres, sipas process-verbalit bashkengjitur, e mbledhur sot me date 06.05.2004 me pjesemarrjen e aksionereve : Ramazan Kalia – Zoterues i 54.53% te aksioneve ;Shteti (perfaqesuar nga Zj. Gjinovefa Arizaj , me Autorizim nr. 2304/3, date 04.05.2004) - Zoterues i 41.766% te aksioneve ; Z. Ilmi Keci – zoterues i 0.094% te aksioneve ; Z. Ismail Taipi – zoterues i 0.094% te aksioneve.

1. Miraton Bilancin mbi llogarite vjetore 2003 dhe raportin e E.K.A.

2. Miraton Zj. Violeta Aloci si Eksperte Kontabel e Autorizuar per auditimin e llogarive per vitin financiar 2004.

Aksionerët :

1. Ramazan Kalia – Zoterues i 54.53% te aksioneve Ramazan Kalia
2. Shteti (perfaqesuar nga Zj. Gjinovefa Arizaj , me Autorizim nr. 2304/3, date 04.05.2004) Zoterues i 41.766% te aksioneve Gjinovefa Arizaj
3. Z. Ilmi Keci – zoterues i 0.094% te aksioneve Ilmi Keci
4. Z. Ismail Taipi – zoterues i 0.094% te aksioneve Ismail Taipi

Noter : Zj. Aida Spahiu Aida Spahiu

Nipt : K 01730502W
Code fiscal : 551649
Swift 12069 NCB , Durres.Al
405/1 Saving Bank.Al

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTERISE DURRES
NOTERE AIDA SPAHIU
Nr 826 Rep

PULLE TAKSE

VERTETIM

Sot ne Durres ne daten 06/05/2004 (dy mije e kater) dite e enjte une notere Aida Spahiu anetare e dhomes se noterise Durres me seli prane gjykates se rrethit Durres ,Lagjia Nr 11 banesa 641 ,asistova ne mbledhjen e zakonshme te asamblese se Aksionereve te shoqerise Anonime 'Mekanike Pjese Ndrimi ' Shkozet Durres dhe vertetoj se Vendimi Nr 1date 06/05/2004 u more nga Asambleja e Zakonshme e shoqerise me pjesemarje perkatesishte :

1- Ramazan Kalia zoterues I 54. 53 % te aksioneve .
2- Shteti (e perfaqesuar me autorizimin me Nr protokolli 2304/3 date 04/05/2004 te leshuar nga Ministria e Ekonomise nga Gjinovefa Arizaj ,specialiste ne Drejtorine e Administrimit te Prones Publike ne Ministrine e Ekonomise) zoterues I 41.766 % te aksioneve .
3- Ilmi Keci zoterues I 0.094 % te aksioneve .
4- Ismail Taipi zoterues I 0.094 % te aksioneve .

Pjesemaresit ne mbledhje jane te gjithe madhore , me zotesi te plote juridike per te vepruar per identitetin e te cileve u sigurova me ane te pashaprtave dhe leternjoftimit te tyre .
Une noterja duke marre pjese ne mbledhjen e zakonshme vertetoj rregullsine ligjore te ketij vendimi .

NOTERE

AIDA SPAHIU

MEKANIKE
PJESË
NDËRRIMI sh.a

Address :
Ish UMB , Shkozet,Durres
Albania
Tel 00355 526 4846
Fax 00355 526 4846
Email< mpnalb@yahoo.com>

Shkozet , Durres , me 06.05.2004

Mbledhja e Asamblese se Zakonshme te Aksionereve te Shoqerise
MPN sh.a.

PROCES – VERBAL I MBLEDHJES

Pjesemarresit ne mbledhje :

1- Ramazan Kalia – Zoterues i 54.53% te aksioneve
2- Shteti (perfaqesuar nga Zj. Gjinovefa Arizaj , me Autorizim nr. 2304 3. date 04.05.2004) – Zoterues i 41.766% te aksioneve.
3- Z. Ilmi Keci – zoterues i 0.094% te aksioneve
4- Z. Ismail Taipi – zoterues i 0.094% te aksioneve.

Pjesemarrja totale perfaqeson 96.478% te Aksioneve te Shoqerise.

Tematika :

1- Vleresimi i vlefshmerise se mbledhjes.

Me miratim unanim te te gjithe pjesemarresve Asambleja zgjodhi Kryetarin e Mbledhjes z.Ramazan Kalia.

Mbledhja konsiderohet e vlefshme dhe cdo pyetje do te marre pergjigje. Miratohet unanimisht.

2- Analiza dhe miratimi i bilancit vjetor 2003 dhe raportit te ekspertit kontabel.

U dhane shpjegime te detajuara mbi Raportin per Auditimin e Llogarive Vjetore te periudhes 01.01.2003-31.12.2004 nga E.K.A , Zj. Marie Dushi.
- Kryetari i Asamblese Z. Ramazan Kalia : I propozoj asamblese qe investimet e kryera ne Shoqeri para disa viteve , te pasqyruara ne Pasiv te

Nipt : K 01730502W
Code fiscal : 551649
Swift 12069 NCB . Durres.Al
405/1 Saving Bank.Al

Address :
Ish UMB . Shkozet.Durres
Albania
Tel 00355 526 4846
Fax 00355 526 4846
Email< mpnalb@yahoo.com>

Bilancit kontabel te Ushtrimit 2003 , si kontribut i Ortakut kryesor , te mos qendrojne me si detyrim , por te kalojne ne kapital , pasi Shoqeria nuk eshte ne gjendje qe t'i shlyeje.
- Ilmi Keci : Mendoj se Shoqeria nuk duhet te mbaje me pajisje dhe makineri te cilat nuk kane asnje vlere tregu.Shoqeria duhet te shese ndonje makineri e cila mund t'i sherbeje ndonje ndermarje tjeter dhe pjesen tjeter t'a shese per skrap.
E.K.A- Sasia e makinerive dhe pajisjeve ze nje vend te konsiderueshem ne llogarite e Shoqerise dhe amortizimi i tyre ka renduar shume gjendjen financiare te Shoqerise.Ne diskutimin e kesaj ceshtje moren pjese dhe te tjere te cilet ishin dakord me parafolesit.

Me aprovimin unanim te te gjithe pjesemarresve , u miratua Bilanci mbi llogarite vjetore 2003.

3- Caktimi i Ekspertit Kontabel te Autorizuar per vitin 2004.

Kryetari i Asamblese propozon caktimin e Zj. Violeta Aloci si Eksperte Kontabel e Autorizuar per auditimin e llogarive vjetore per vitin financiar 2004.

Me aprovimin unanim te te gjithe pjesemarresve miratohet.

Meqenese nuk kishte ceshtje te tjera per te diskutuar , Mbledhja e Asamblese se Zakonshme te Aksionereve te Shoqerise MPN sh.a , deklarohet e mbyllur.

Nenshkrimi i pjesemarresve :

1- Ramazan Kalia – Zoterues i 54.53% te aksioneve

Ramazan Kalia

Address :
Ish UMB , Shkozet,Durres
Albania
Tel 00355 526 4846
Fax 00355 526 4846
Email< mpnalb@yahoo.com>

2- Shteti (perfaqesuar nga Zj.Gjinovefa Arizaj , me Autorizim nr. 2304/3, date 04.05.2004) Zoterues i 41.766% te aksioneve

Gjinovefa Arizaj

2- Ilmi Keci – zoterues i 0.094% te aksioneve

Ilmi Keçi

3- Ismail Taipi – zoterues i 0.094% te aksioneve

Ismail Taipi

Ne perfundim te mbledhjes protokolli i mbledhjes u firmos rregullisht nga pjesemarresit ne prani te noteres .

Zj. Aida Spahiu Aida Spahiu

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AIDA M. SPAHIU
NOTER
DURRES

Date 06.05.2004

URDHER REGJISTRIMI

Me

1. 21.244

2.a. Vezime Tjerve te Ndeminit Dunes Sh.A

b. Dunes

c. Tredeniu me fraksi te Tjerve te ndeminit per bujane transport ity.

c. 79.4000 ndeln, 79.4000 dhsem me veri 1000 lekt.

3. Ne yane Lilo
Agi Kadumari
Tranvers Zemel.

4. Statuti nenshkruar me date 17.02.199

5. Data 18.04.1999

Statuti 8. Fiete

Njoftime: a. shogerla

b. dhomen e tregtise

c. organit perkates financiar

d. zyres se statistikes

Publikime:

Defrenlan
Ndeln N. 15 ent
12 1998

Vertu / Vlesen
19.04.99

GJYQTARE

S T A T U T
I
SHOQERISE ANONIME

NENI 1
Emertimi dhe selia

Shoqeria anonime krijohet nga transformimi i ndermarrjes shteterore Uzina Mekanike Pjeseve Nderrimit Durres .

Shoqeria e krijuar ne kete menyre emerohet Sh.A "Mekanike Pjeseve Nderrimit" Durres .

Selia e shoqerise eshte ne adrese : Durres

NENI 2
Objekti i shoqerise

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :
-Prodhim me porosi per te tretet si per bujqesine,ndertimin,transportin
- Shoqeria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje çdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejteperdrejte ose terthorazi me objektin e saj. Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqerive te reja, si dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera jashte vendit.

NENI 3
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 79.400.000 leke. Nga ku vlera e truallit eshte 6.641.935 leke. Numri i aksioneve eshte 683.636. Vlera nominale e aksionit eshte 1000 leke.

NENI 4
Transferimi i aksioneve ne rast privatizimi

Transferimi i aksioneve ne rastin e privatizimit do te kryhet me Urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit ne baze te legjislacionit ne fuqi per privatizimin.

NENI 5
Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane :

1) Keshilli mbikqyres
2) Drejtoria

NENI 6
Keshilli Mbikqyres

- Keshilli mbikqyres perbehet nga 3 (tre) anetare. Anetaret e keshillit mbikqyres emerohen nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Priatizimit.
- Kohezgjatja e fuksionit te tyre eshte 4 (kater) vjet. Anetaret e keshillit mbikqyres jane te gjithe te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga titullari i organit qe i ka emeruar per shkaqe te perligjura.
- Anetaret e keshillit mbikqyres jane persona fizike. Ata nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri.
- Ne se nje ose disa vende te anetareve te keshillit mbikqyres mbeten bosh per shkak vdekje, shkarkimi ose doreheqje, zevendesimi duhet te kryhet jo me vone se 3 (tre) muaj. Anetari i keshillit mbikqyres i emeruar me zevendesim te nje anetari tjeter, perfundon mandatin e paraardhesit..
- Anetaret e keshillit mbikqyres te moshes mbi 65 (gjashtedhjete e pese) vjeç nuk mund te jene me shume se 1/3 (nje e treta) e numrit te pergjithshem te keshillit mbikqyres. Ne se ky raport tejkalohet anetari me i moshuar do te konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

NENI 7
Kryetari dhe zevendeskryetari i keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres zgjedh ndermjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendeskryetar, te cilet therresin mbledhjen e keshillin dhe te drejtojne diskutimet. Ata zgjidhen per te gjithe kohen e mandatit te tyre dhe jane te rizgjedhshem.
Keshilli mbikqyres mund te ngarkoje nje person si sekretar edhe jashte anetareve te tij.
Ne rast mungese ose pengimi te kryetarit, mbledhjet e keshillit mbikqyres drejtohen nga zevendeskryetari.

NENI 8
Vendimet e keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres mblidhet sa here qe e kerkon interesi i shoqerise, me thirrjen e kryetarit, ose ne mungese te tij, te zevendeskryetarit. Kryetari duhet te therrase mbledhjen e keshillit mbikqyres brenda 15 (pesembedhjete) diteve kur drejtoria ose 1/3 (nje e treta) e anetareve te keshillit mbikqyres i paraqitin atij nje kerkese te motivuar per kete qellim. Nese kerkesa mbetet pa pergjigje, atehere anetaret mund te therresin mbledhjen e keshillit mbikqyres, duke i percaktuar rendin e dites. Ne parim thirrja duhet te behet 3 (tre) dite perpara, me leter, telegram, teleks ose fax. Por thirrja mund te jete e vlefshme edhe me goje dhe pa afat ne se anetaret e keshillit mbikqyres do ta pranojne ate. Çdo thirrje duhet te percaktoje rendin e dites.
Mbledhja e keshillit mbikqyres zhvillohet ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te percaktuar ne thirrje. Keshilli mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem vetem ne se jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te tij. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem, ne rast barazimi votash, ajo e kryetarit eshte percaktuese.
Keshilli mbikqyres mban nje regjister te pjesemarrjes ne mbledhjen e tij, i cili nenshkruhet nga anetaret e pranishem ne mbledhje. Vendimet e keshillit mbikqyres evidentohen me pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi, nga kryetari ose zevendeskryetari.
Kopjet e vendimeve vertetohen nga kryetari ose zevendeskryetari i keshillit mbikqyres.

NENI 9
Kompetencat e keshillit mbikqyres

- Keshilli mbikqyres ushtron kontroll te perhershem per administrimin e shoqerise nga drejtoria dhe i jep kesaj te fundit autorizimin per kryerjen e operacioneve qe nuk mund te kryhen nga drejtoria pa autorizimin e keshillit mbikqyres.
- Keshilli mbikqyres emeron drejtorine. Keshilli mbikqyres cakton njerin prej anetareve te drejtorise me cilesine e drejtorit.
- Me emerimin e anetareve te drejtorise keshilli mbikqyres lidh kontrate me ta per detyrimet qe rrjedhin ne administrimin e shoqerise.
- Keshilli mbikqyres autorizon drejtorine qe te kryeje veprimet dhe te realizoje marreveshjet e parashikuara ne nenet 12 dhe 13 te statutit.
- Keshilli mbikqyres ka te drejte te kryeje ne çdo kohe verifikime dhe kontrolle qe ia i çmon te pershtatshme dhe te njihet me dokumentacionin qe i gjykon te nevojshem per permbushjen e detyres se tij.
- Drejtoria i paraqet raport keshillit mbikqyres te pakten njehere ne tre muaj. Brenda tre muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar drejtoria duhet t'i paraqese keshillit mbikqyres llogarite vjetore me qellim verifikimi dhe kontrolli.
- Keshilli mbikqyres i propozon Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit lidhur me keto çeshtje :

  a) Percaktimin dhe ndryshimin e programit te veprimtarise afatshkurter, afatmesme dhe afatgjate te shoqerise.
  b) Kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
  c) Hapjen e veprimtarive ose njesive te reja dhe ndryshimin e objektit te shoqerise.
  d) Shitjen e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te shoqerise.
  e) Krijimin e shoqerive te reja dhe pjesmarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera.
  f) Marrjen e huave afatmesme, afatgjata.
  g) Si dhe per çdo çeshtje tjeter qe ne baze te ligjit "Per shoqerite tregtare" eshte kompetence e Asamblese se Pergjithshme.

NENI 10
Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres do te behet ne perputhje me kriteret e percaktuara me Vendim te Keshillit te Ministrave.

NENI 11
Drejtoria

- Shoqeria administrohet nga drejtoria e cila mund te perbehet nga nje ose disa anetare. Numri i anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres me nje vendim te tij.
- Drejtoria emerohet nga keshilli mbikqyres kur per te jane dakord jo me pak se 2/3 (dy te tretat) e te gjithe anetareve te ketij keshilli.
- Anetaret e drejtorise jane persona fizike, ne te kundert emerimi i tyre eshte i pavlefshem. Ata mund te zgjidhen dhe jashte te punesuarve ne shoqeri. Nese nje anetar i keshillit mbikqyres emerohet anetar i drejtorise mandati i tij ne keshillin mbikqyres perfundon. Nje person nuk mund te emerohet anetar drejtore ose drejtor ne me shume se nje shoqeri. Anetaret e drejtorise mund te shkarkohen nga keshilli mbikqyres per shkaqe te perligjura. Ne rastin kur i interesuari ka lidhur kontrate punesimi me shoqerine, shkarkimi i tij nga fuksioni i anetarit te drejtorise nuk eshte shkak per zgjidhjen e kontrates.
- Anetaret e drejtorise emerohen per nje periudhe kohe prej 4 (kater) vjetesh. Ne rastet e pushimeve dhe mungesave te zgjatura, keshilli mbikqyres ben zevendesimin e tyre.
- Anetaret e drejtorise jane te riemerueshem, ata nuk mund te jene mbi moshen 65 (gjashtedhjete e pese) vjeç. Anetari i drejtorise qe mbush moshen 65 (gjashtedhje e pese) vjeç konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.
- Paga e anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres ne aktin e emerimit te tyre.

NENI 12
Kompetencat e drejtorise

- Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer te shoqerise.
- Ne marredheniet me te tretet shoqeria merr persiper detyrime qe rrjedhin nga aktet e drejtorise te nenshkruara nga anetari me cilesine e drejtorit edhe kur keto e tejkalojne objektin e veprimtarise se shoqerise, perveç rastit kur shoqeria provon se te tretet e dinin qe akti i drejtorise kapercente objektin e veprimtarise se shoqerise dhe vepronte me keqbesim, ose kur te tretet nuk mund te injoronin kete akt, duke pasur parsysh faktin se shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.
- Aktet me te cilat shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve duhet te nenshkruhen nga anetari me cilesine e drejtorit ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit per keto akte.
- Drejtoria merr vendim me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem kur jane prezent jo me pak se gjysma e anetareve te saje. Ne rast barazimi votash, vota e anetarit te caktuar me cilesine e drejtorit eshte percaktuese.
- Lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet dhe me vlere mbi 2 (dy) milion leke behet me autorizim te keshillit mbikqyres.
- .Marredheniet brenda shoqerise percaktohen me rregullore qe miratohet nga keshilli mbikqyres.
- Drejtoria ben strukturen e organizimit te shoqerise te cilen e miraton keshilli mbikqyres.

NENI 13

Marreveshjet ndermjet shoqerise dhe drejtorise ose te nje anetari te keshillit mbikqyres

Çdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe anetereve te drejtorise ose nje anetari te keshillit mbikqyres, qofte e drejteperdrejte ose jo e drejteperdrejte duhet t'i nenshtrohet autorizimit paraprak te keshillit mbikqyres.
Percaktimi i mesiperm eshte i vlefshem edhe per marreveshjet ndermjet shoqerise dhe nje shoqerie tjeter, kur nje anetar i keshillit mbikqyres eshte edhe anetar i keshillit mbikqyres te nje shoqerie tjeter, me te cilen propozohet te lidhet mareveshje. Kjo nuk eshte e zbatueshme per mareveshjet qe kane te bejne me veprimtarine rrjedhese te shoqerise qe kryhen ne kushte normale.
Anetari i drejtorise ose i keshillit mbikqyres i interesuar duhet te njoftoje keshillin mbikqyres per nje marreveshje per te cilen zbatohet kerkesat e ketij neni te statutit. Anetari i interesuar i keshillit mbikqyres nuk merr pjese ne votimin per dhenien e autorizimit.

NENI 14
Eksperti kontabel i autorizuar

Kontrolli i shoqerise ushtrohet nga 1 (_nje_) eksperte kontabel te autorizuar, te cilet emerohen nga aksionmbajtesi i vetem dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin.

NENI 15
Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohen nga data e rregjistrimit ne rregjistrin tregtar deri me 31 Dhjetor.

NENI 16
Inventari -llogarite vjetore

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitetit te rregullt te pasurise dhe te vperimtarise se saj ne pajtim me kerkesat ligjore. Ne mbylljen te ushtrimit, drjtoria harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar. Drejtoria pergatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar.

NENI 17
Rezultati i ushtrimit dhe percaktimi i fitimit

Rezultati i ushtrimit percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem.
Nga fitimet e ushtrimit, te paksuara kur eshte rasti me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5 % (pese perqind) per te krijuar rezerven e domosdoshme.
Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme nuk eshte detyrueshme kur kjo rezerve arrin 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit themeltar. Ajo rifillon per nje arsye çfaredo, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 1/10 (nje te dhjetat) e kapitalit.
Perdorimi i fitimit pas zbritjes se rezerves ligjore behet me urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit.

NENI 18
Emerimi i anetareve te pare te keshillit mbikqyres

1. Si anetare te pare te keshillit mbikqyres emerohen:

- Genc Celo
- Alqi Kadenasi
- Pranvera Zeneli

NENI 19
Emerimi i ekspertit kontabel te pare te autorizuar

Ekspert i (te) pare kontabel i (te) autorizuar emerohet (n)

1) Z. Sabri Zalla

NENI 20
Asambleja e pergjithshme

Te gjitha kompetencat e asamblese se pergjithshme te parashikuar nga ligji Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" qe nuk jane shprehur ne kete statut, ushtrohen nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit me cilesine aksionerit te vetem.

NENI 21
Dispozita te fundit

Ne nje afat prej 6 (gjashte) muajsh nga data e rregjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregtar, drejtori i shoqerise do te jete drejtori i ish-ndermarrjes shteterore. Gjate ketij afati ai mund te shkarkohet nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit veç per shkaqe te perligjura.

NENI 22

Per çfare nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet dispozitave te legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregtare.

Z/V MINISTRI
PAJTIM BELLO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT
TIRANE

KERKESE

KERKUES: Ramazan Kalia, i biri i Hamitit, i datelindjes 1963, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar me cilesine e drejtorit te shoqerise " Mekanike Pjese Nderrimi" Sh. a Durres;

OBJEKTI: Depozitimin prane zyres se Regjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare te vendimit date 20.09.2002 te mbledhjes se asamblese se shoqerise anonime "Mekanike Pjese Nderrimi" Durres.

BAZA LIGJORE: Ligji 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligji 7667 "Per rregjistrimin tregtar".

GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

Shoqeria "Mekanike Pjese Nderrimi"Sh.a eshte rregjistruar prane Gjykates se Rrethit Tirane me vendim Nr. 21244, date 29.04.1999, si shoqeri anonime. Une, drejtori i shoqerise "Mekanike Pjese Nderrimi" Sh.a Durres, paraqes perpara Gjykates se Shkalles se Pare Tirane:

